

Të nderuar Anëtarë,

Për mbrojtjen e shëndetit tuaj dhe të personave që ju rrethojnë,

për shkak të situatës aktuale të krijuar nga prania e COVID19 në Shqipëri

ALB-Progres ka ndërmarrë disa masa që synojnë parandalimin e përhapjes së virusit nëpërmjet grumbullimit të njerëzve në hapësira të mbyllura.

Në lidhje me sa më sipër, jeni të lutur që brenda ambienteve të degëve ALB-Progres të mbani parasysh dhe të zbatoni disa rregulla të thjeshta:

1. Hyrja e klientëve në degët e SHKK ALB-Progres të bëhet e kontrolluar, duke lejuar që brenda në degë të qëndrojnë aq anëtarë/klientë sa punonjës të ALBPROGRESIT ka në dispozicion në arkë dhe në shërbim.
2. Ju rekomandojmë gjithashtu që në radhë, jashtë ambientit të degës, të respektoni distancën e sigurisë dhe në degët e ALB-Progres të hyni sipas udhëzimit të punonjësit të shoqërisë i cili do të monitorojë numrin e anëtarëve/klientëve në degë.
3. Të merrni shërbimet në degë i vetëm, jo në grup.
4. Të dizinfektoni duart në fillim dhe përfundim të komunikimit/ ndërveprimit me shërbimin e klientit.
5. Të shmangni takimet dhe prekjet fizike me punonjësit e Shkk-se.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

***Shënim: Gjatë këtyre ditëve është e këshillueshme që në degët e ALB-Progres të mos hyjnë persona që kanë udhëtuar së fundmi në vende të konsideruara me rrezikshmëri të lartë nga OBSH, si: Kina, Italia, Koreja e Jugut dhe Irani.***